**LIGJ**
**Nr.9367, datë 7.4.2005**

# PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

## KREU I
## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është garantimi i një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publike, nëpërmjet parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave publikë dhe atyre privatë të një zyrtari në ushtrimin e funksioneve të veta.

### Neni 2
### Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave, mjeteve, mënyrave, procedurave, përgjegjësive dhe kompetencave për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe dënimin e rasteve të konfliktit të interesave.

### Neni 3
### Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. "Konflikt i interesit" është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

2. "Kryerje në mënyrë të drejtë e detyrave dhe përgjegjësive" është mënyra e kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive, të materializuara në një vendimmarrje, në të cilën zyrtari vepron në përputhje me ligjin, me ndershmëri, paanshmëri, përgjegjësi, përkushtim, në afat, në mbrojtje, në çdo rast, të interesit publik dhe të drejtave të ligjshme të personave privatë, si dhe për ruajtjen dhe forcimin e besueshmërisë e të dinjitetit të institucionit ku punon, të shtetit në përgjithësi dhe të figurës së zyrtarit.

3. "Kryerje në mënyrë të padrejtë e detyrave dhe e përgjegjësive" është rasti kur nuk plotësohet të paktën njëra prej kërkesave të pikës 2 të këtij neni për shkak dhe vetëm të ndikimit të mundshëm të interesave privatë të zyrtarit, sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Konflikti i interesit, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, përfshin disa përkufizime të tjera, për lloje të ndryshme të shfaqjes së tij, si më poshtë:

a) "konflikt faktik i interesit" është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij zyrtare;

b) "konflikt në dukje i interesit" është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësive të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë;

c) "konflikt i mundshëm i interesit" është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit mund të shkaktojnë, në të ardhmen, shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara;

ç) "konflikt rast për rast i interesit" është gjendja me konflikt interesi, në njërën nga tri llojet e mësipërme, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë;

d) "konflikt i vazhdueshëm i interesit" është gjendja, në të cilën konflikti i interesit mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshtë në të ardhmen.

5. "Zotërim aktiv i aksioneve ose i pjesëve në kapital" është ushtrimi i plotë i të gjitha të drejtave, që burojnë nga pronësia mbi aksionet ose pjesët në kapital.

6. "Zotërim pasiv i aksioneve ose i pjesëve në kapital" është gjendja, në të cilën pronari ruan të drejtën e përfitimit të fryteve civile të pronësisë, por nuk mund të ushtrojë vetë asnjë veprim tjetër civil mbi këtë pronë. Të gjitha veprimet e tjera (administrim, zotërim, tjetërsim etj.) kryhen nga një person i besuar nga pronari, bazuar në një marrëveshje të lidhur ndërmjet tyre, që përcakton kriteret e përfitimit të fryteve të pasurisë, si dhe të drejta e detyrime të tjera të domosdoshme. I besuari nuk shkëmben asnjë mendim dhe asnjë informacion me pronarin dhe as nuk ndikohet nga ai për kryerjen e këtyre veprimeve me pasurinë. I besuari duhet të veprojë vetëm në të mirën e ruajtjes dhe rritjes së pasurisë, me të njëjtin motivim sikur këto veprime të kryheshin nga vetë pronari. Kufizimet në përzgjedhjen e të besuarit jepen në këtë ligj. Palët, në çdo rast, ruajnë të drejtën e zgjidhjes së kësaj marrëveshjeje. Pronari ka të drejtë të rimarrë, në çdo kohë, të drejtat e kryerjes së veprimeve të tjera civile me pronësinë, kur, sipas këtij ligji, kushtet që e diktuan këtë veprim nuk ekzistojnë më. Të drejtat dhe detyrimet e tjera, të papërmendura më sipër, rregullohen nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.

7. "Zyrtar" është çdo person, që kryen detyra dhe ushtron funksione publike, sipas përcaktimit të shkronjave "a", "b" e "c" të pikës 1 të nenit 4 të këtij ligji.

8. "Institucion publik" është çdo subjekt, i përcaktuar në shkronjat "ç" e "d" të pikës 1 të nenit 4 të këtij ligji.

9. "Epror i një zyrtari" është një zyrtar tjetër, një njësi organizative brenda institucionit publik, drejtuesi më i lartë i institucionit publik ose një organ i këtij institucioni, që ka kompetenca emëruese, drejtuese, urdhëruese, vlerësuese ose kontrolluese, të drejtpërdrejta mbi këtë zyrtar, ose që i janë dhënë kompetenca të caktuara për zbatimin e këtij ligji.

10. "Institucion epror" është një institucion publik (ose organ i një institucioni publik) që, sipas ligjeve në fuqi, ka kompetenca rregulluese, emëruese, drejtuese, urdhëruese, vlerësuese ose kontrolluese mbi një institucion tjetër publik (ose organ të tij), ku, në këtë të fundit, një zyrtar kryen detyrat dhe ushtron kompetencat e tij. Roli epror ushtrohet në përputhje me ligjet, që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e institucioneve publike. Pavarësisht nëse një institucion epror mund të ketë njërën nga kompetencat e mësipërme, ai nuk mund të vlerësohet i tillë, nëse kjo do të çonte në cenimin e parimeve kushtetuese të ndarjes së pushteteve dhe të autonomisë institucionale.

11. "Person i lidhur me një zyrtar" është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jopasurore, sipas nenit 5 të këtij ligji, me zyrtarin.

12. "Parim i proporcionalitetit" është raporti ndërmjet rëndësisë së detyrave,

përgjegjësive dhe kompetencave të një zyrtari ose institucioni publik me masat për parandalimin e konfliktit të interesave, raport në të cilin sa më të rëndësishme të jenë detyrat, përgjegjësitë ose kompetencat e zyrtarit, aq më të shumta janë kufizimet e interesave të zyrtarit, aq më të ashpra janë dënimet dhe në mënyrë edhe më të hollësishme janë përcaktuar rregullat, mënyrat, mjetet dhe procedurat për parandalimin e konfliktit të interesit nga institucionet publike.

13. "Person fizik tregtar" përdoret sipas kuptimit të përcaktuar nga legjislacioni tregtar.

Neni 4
**Fusha e zbatimit**

1. Dispozitat e këtij ligji përcaktojnë rregulla të detyrueshme për t'u zbatuar nga:

a) çdo zyrtar, kur ai merr pjesë në një vendimmarrje për:

i) akte dhe kontrata administrative;

ii) akte të organeve gjyqësore, noteriale, për ekzekutimin e titujve ekzekutivë nga organet e përmbarimit dhe akte të organeve të prokurorisë;

iii) akte normative, si dhe vetëm ato ligje që krijojnë pasoja juridike për subjekte individualisht të përcaktuara;

b) çdo zyrtar i institucioneve shtetërore, qendrore ose vendore dhe çdo punonjës i subjekteve të përcaktuara në shkronjën "d" ose përfaqësues i subjekteve të përcaktuara në shkronjën "ç", në subjektet e përmendura në shkronjën "d", kur ai merr pjesë në një vendimmarrje për kontrata, që krijojnë marrëdhënie juridiko-civile, me palë këto subjekte;

c) çdo zyrtar ose punonjës, që ndodhet në pozicione, ka përgjegjësi, kryen detyra ose ushtron kompetenca të llojeve konkrete, të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj, në njërën nga subjektet e shkronjës "ç" ose "d" të pikës 1 të këtij neni;

ç) çdo institucion shtetëror, qendror ose vendor;

d) çdo organ apo subjekt i krijuar dhe/ose në varësi të subjekteve të shkronjës "ç", përfshirë edhe ndërmarrjet shtetërore ose vendore, shoqëritë tregtare me pjesëmarrje kontrolluese të kapitalit shtetëror ose vendor, organizatat jofitimprurëse dhe persona të tjerë juridikë, të kontrolluar nga subjektet e shkronjës "ç" ose nga vetë subjektet e kësaj shkronje;

dh) personat e lidhur në masën dhe mënyrën e përcaktuar në këtë ligj.

2. Për qëllimet e këtij ligji:

a) vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit;

b) vendimmarrje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes, sipas shkronjës "a" të kësaj pike, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit;

c) një zyrtar ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas shkronjave "a" ose "b" të kësaj pike, përcaktojnë përmbajtjen e aktit.

Neni 5
**Interesat privatë**

1. Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga:

a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre;

b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;

c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;

ç) negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;

d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;

dh) marrëdhënie:

i) familjare apo të bashkëjetesës;

ii) të komunitetit;

iii) etnike;

iv) fetare;

v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë;

e) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni.

2. Kufizimet e interesave privatë, të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj, zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat, të përcaktuara shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit, që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë.

3. Nëse në këtë ligj, në lidhje me një interes të caktuar privat të një zyrtari, nuk është përcaktuar ndonjë kufi sasior i kufizimit të këtij interesi, ndërsa në një ligj tjetër i njëjti interes, me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave, kufizohet shprehimisht sipas një kufiri sasior, atëherë ky kufizim zbatohet edhe për këtë ligj dhe anasjelltas.

4. Vlerësohet shkak për lindjen e konfliktit të interesit, çdo lloj interesi privat i një zyrtari nga ata të përcaktuar në këtë nen, çdo lidhje apo gërshetim ndërmjet dy a më shumë prej tyre, nëse për shkak të këtij interesi ose për shkak të daljes jashtë kufizimeve të detyrueshme të këtij interesi, shfaqet një gjendje me konflikt interesi, sipas përkufizimeve të pikave 1 e 4 të nenit 3 të këtij ligji.

Neni 6

**Mënyra e kryerjes së detyrave publike dhe detyrimi për parandalimin e konfliktit të interesit**

1. Me zgjedhjen ose emërimin e tij e në vazhdim, zyrtari ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë, sa më parë dhe në mënyrën më të frytshme të mundshme, çdo gjendje të konfliktit të tij të interesit. Në rast se zyrtari nuk është i bindur për ekzistencën apo jo të një konflikti interesi të lidhur me të, ai duhet të këshillohet sa më parë me eprorët.

2. Çdo epror dhe institucion epror duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit.

KREU II

PROCEDURAT DHE MJETET PËR IDENTIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN E KONFLIKTEVE TË INTERESAVE

Seksioni 1

**Identifikimi dhe regjistrimi i interesave në kushtet e konflikteve rast për rast të interesave**

Neni 7

**Deklarimi rast për rast i interesave privatë të zyrtarit**

1. Çdo zyrtar, në ushtrimin e kompetencave apo në kryerjen e detyrave të tij publike, në bazë të njohjes së tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarim paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesave të tij privatë, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi.

2. Deklarimi rast për rast i interesave privatë bëhet çdo herë nga zyrtari, kur kjo kërkohet

nga eprori ose nga institucioni epror. Deklarimi, si rregull, duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi mund të kërkohet dhe të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur.

3. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë bëhet si rregull me shkrim, kur zyrtari përfshihet në një vendimmarrje për një akt. Deklarimi me shkrim nuk është i domosdoshëm kur deklarimet verbale të zyrtarit janë të regjistrueshme dhe të dokumentueshme, sipas procedurave të përcaktuara me ligj dhe/ose në rregulloret e brendshme të institucionit publik, ku zyrtari ushtron funksionet e veta.

4. Deklarimi i interesit për rastet e përcaktuara në shkronjën “dh”, “iii”, “iv” dhe “v” të pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji, si dhe përkatësia në organizata politike në kuptim të shkronjës “d” të pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji bëhet vetëm me vullnetin e lirë të zyrtarit.

Neni 8

**Identifikimi i interesave privatë të zyrtarit nga persona të tretë**

Ofrimi i informacionit, për interesat privatë të zyrtarit, është:

a) detyrë e çdo zyrtari tjetër që ka dijeni, në veçanti e eprorit të tij;

b) detyrë e çdo institucioni publik, që ka dijeni;

c) e drejtë e palëve të interesuara, që preken nga veprimet e zyrtarit;

ç) e drejtë e çdo personi, i cili ka dijeni dhe që ka një interes në përgjithësi e që përputhet me qëllimin e këtij ligji.

Neni 9

**Burime të tjera informacioni për interesat privatë të zyrtarit**

Burime të tjera informacioni për interesat privatë të një zyrtari mund të jenë edhe:

a) regjistrat publikë ose privatë, të mbajtur në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) të dhënat nga media;

c) të dhënat ose ankesat nga publiku;

ç) çdo burim tjetër i ligjshëm.

Neni 10

**Roli aktiv i institucioneve publike në mbledhjen e informacionit për interesat privatë të zyrtarit**

1. Autoriteti ose struktura përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji, sipas nenit 41 pika 2 të tij, në përputhje me masën, mënyrën dhe radhën e përcaktuar në këtë ligj dhe/ose në aktet nënligjore e rregulloret e brendshme të një institucioni publik, të nxjerra në zbatim të këtij ligji, është i autorizuar që, në mënyrë aktive, në emër të institucionit publik përkatës:

a) të mbledhë, nga burimet e ligjshme të informacionit, të dhëna për interesat privatë të një zyrtari;

b) të pranojë informacionet e siguruara në mënyrë të ligjshme;

c) të verifikojë besueshmërinë e këtyre informacioneve;

ç) të vërë në dijeni zyrtarin për informacionet e siguruara për të;

d) t'i japë mundësi zyrtarit të provojë të kundërtën, nëse ky i fundit e kërkon një gjë të tillë;

dh) të bëjë regjistrimin e interesave privatë të zyrtarit.

2. Çdo zyrtar, jo më vonë se 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga data e fillimit të marrëdhënieve të punës në një institucion publik, është i detyruar të lëshojë një autorizim, në favor të institucionit publik ku ushtron funksionet, nëpërmjet të cilit ai e autorizon këtë institucion që të kryejë kontroll dhe të sigurojë të dhëna vetjake për zyrtarin, kudo ku ato janë regjistruar. Ky autorizim ka të njëjtën vlerë edhe për çdo institucion epror.

3. Çdo institucion epror, sipas hierarkisë, është i autorizuar që, në mënyrë aktive, të kryejë të gjitha veprimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni edhe për titullarët e institucioneve të tjera, që ka në juridiksion.

Neni 11
**Regjistrimet rast për rast të konfliktit të interesit**

Për çdo rast të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, regjistrohen identiteti i zyrtarit, interesat private të tij, shkak për një konflikt interesi, thelbi i konfliktit, palët e interesuara, burimi i të dhënave, mënyra e marrjes dhe e verifikimit të tyre, si dhe vendimi që është marrë, mbështetur në këto të dhëna, përfshirë edhe vendimet e marra nga eprorët, institucionet eprore ose nga gjykatat.

Regjistrimi bëhet nga autoriteti përgjegjës, sipas nenit 41 të këtij ligji.

Neni 12
**E drejta e publikut për t'u njohur me regjistrimet për të dhënat private të zyrtarëve, në rastet e konflikteve rast për rast të interesit**

1. Regjistrimet e kryera sipas nenit 11 të këtij ligji janë dokumente zyrtare, për të cilat publiku mund të vihet në dijeni, në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

2. Regjistrimet e interesave, për qëllimet e një procedimi administrativ, u vihen në dispozicion, në kohë të arsyeshme, palëve në këtë procedim, sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

3. Dispozitat e pikave 1 e 2 të këtij neni nuk zbatohen për mbledhjet e Këshillit të Ministrave, si dhe për mbledhjet e mbyllura të Kuvendit, të këshillit komunal ose bashkiak dhe të organeve të tjera kolegjiale, qendrore ose vendore.

4. Regjistrimet janë gjithnjë të disponueshme për një proces gjyqësor ose arbitrimi, si dhe për një proces hetimi parlamentar.

Neni 13
**Procedura të veçanta**

l. Për Presidentin e Republikës nuk gjejnë zbatim përcaktimet e pikës 2 të nenit 7 të këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur ai ushtron funksionet si anëtar i një organi kolegjial, si dhe kur kjo ka të bëjë me një proces gjyqësor ndaj tij.

2. Për proceset gjyqësore dhe hetimet parlamentare, identifikimi dhe regjistrimi i interesave, sipas këtij kreu, bëhen vetëm për ato veprime, që kryhen para dhe jashtë një procesi konkret gjyqësor civil, një procedimi penal ose hetimi parlamentar. Brenda këtij procesi, identifikimi dhe regjistrimi i interesave kryhen sipas rregullave të përcaktuara, sipas rastit, në kodet e procedurave civile dhe penale, si dhe të legjislacionit që rregullon procesin e hetimit parlamentar.

Seksioni 2
**Identifikimi dhe regjistrimi periodik i interesave privatë**

Neni 14
**Zyrtarët që mbartin detyrimin për deklarim periodik të interesave privatë**

1. Janë të detyruar të bëjnë deklarim periodik të interesave, në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, të gjithë zyrtarët e përcaktuar në pikën 1 të nenit 3 të ligjit

nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", së bashku me kategoritë e zyrtarëve, të përcaktuara në nenet 27 deri 33 të këtij ligji.

2. Kuvendi, me propozimin e Inspektorit të Përgjithshëm, vendos detyrimin për deklarim periodik edhe për funksione të tjera, të paparashikuara në këtë ligj.

3. Për qëllim të deklarimit periodik, ndër personat e lidhur me zyrtarin, mbartin detyrim për deklarim vetëm bashkëshorti/ja dhe fëmijët madhorë, sipas gjendjes familjare, të përcaktuar në certifikatë për periudhën e deklarimit.

4. Personat e tjerë, të lidhur me një zyrtar, sipas këtij ligji, bëjnë deklarim të interesave, me kërkesë të Inspektorit të Përgjithshëm, kur kjo gjykohet e domosdoshme nga ky i fundit, për nevojat e verifikimit të deklarimit të zyrtarit. I besuari, sipas kuptimit të neneve 3 pika 6 dhe 38 pika 3 të këtij ligji, vlerësohet person i lidhur.

5. Deklarimi i interesave shoqërohet me një autorizim të veçantë, ku deklaruesi autorizon organet e përcaktuara në këtë ligj të verifikojnë të gjitha subjektet, private e publike, brenda dhe jashtë vendit, për të dhënat e deklaratës. Deklarimi lëshohet brenda 15 ditëve nga mbarimi i afatit për deklarim.

Neni 15

**Llojet e interesave privatë, që deklarohen periodikisht**

1. Interesat privatë, që deklarohen periodikisht janë:

a) pasuritë, detyrimet financiare, si dhe të gjitha kërkesat e përcaktuara në nenin 4 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë";

b) ata të përcaktuar në shkronjën "c" të pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji, përjashtuar premtimet dhe favoret, përfshirë identitetin e personit fizik ose juridik, prej nga vijnë apo krijohen dhuratat a trajtimet preferenciale. Nuk deklarohen dhurata ose trajtimi preferencial kur vlera e tyre është më e vogël se 10 000 (dhjetë mijë) lekë, si dhe kur dy e më shumë dhurata ose trajtime preferenciale, të dhëna nga i njëjti person, së bashku, nuk e kalojnë këtë vlerë, gjatë së njëjtës periudhë deklarimi;

c) ata të përcaktuar në shkronjën "d" të pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji, përfshirë çdo lloj të ardhure, të krijuar nga kjo veprimtari ose angazhim.

2. Interesat privatë, të përcaktuar në shkronjën "dh", "iii", "iv" dhe "v" të pikës 1 të nenit 5, si dhe përkatësia në organizata politike, në kuptim të shkronjës "d" të pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji, nuk deklarohen dhe nuk kërkohet të deklarohen.

3. Interesat privatë të llojeve të tjera nga ato të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji mund të kërkohen të deklarohen periodikisht, nëse kjo është e mundur dhe e përshtatshme për nënlloje interesash brenda këtyre llojeve, sipas përcaktimeve të Inspektorit të Përgjithshëm.

4. Kur zyrtari transferon të drejtat e zotërimit aktiv të aksioneve ose të pjesëve në kapital, sipas pikës 3 të nenit 38 të këtij ligji, në deklarimin periodik, për sa kohë vazhdon kjo gjendje, ai deklaron vetëm gjendjen e këtyre të drejtave para transferimit dhe frytet e pasurisë, të cilat ai ka marrë efektivisht gjatë vitit për të cilin bëhet deklarimi.

5. Në rastin e deklarimit para fillimit të punës, sipas të njëjtit kuptim të këtij termi, të përcaktuar në nenin 9 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", deklarohen vetëm:

a) interesat e përcaktuar në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij neni, të grumbulluar deri në ditën e fillimit të detyrës, përjashtuar burimet e krijimit të tyre;

b) interesat e përcaktuar në shkronjën "d" të pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji, por vetëm ato angazhime dhe veprimtari, që ekzistojnë në datën e fillimit të punës, përfshirë çdo lloj të ardhure të krijuar nga këto angazhime ose veprimtari nga data 1 janar deri në datën e fillimit të punës të vitit të deklarimit.

6. Deklarimi pas largimit nga funksioni, sipas të njëjtit kuptim të këtij termi, të shprehur në nenin 8 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", kryhet vetëm një herë, në datën e largimit nga funksioni, me përjashtim të rastit kur zyrtari fillon punë në një detyrë tjetër, që, sipas këtij ligji, vazhdon të mbartë detyrimin për deklarim.

7. Në deklarimin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në interesat privatë, të deklaruar më parë, sipas pikës 1 të këtij neni, interesat e lindur gjatë vitit që deklarohet dhe çdo e ardhur e fituar gjatë gjithë vitit për të cilin bëhet deklarimi.

Të gjithë zyrtarët dhe personat e tjerë të lidhur, që mbartin detyrim për deklarim, sipas pikave 1, 2 e 3 të nenit 14 të këtij ligji, detyrohen të paraqesin deklaratën e tyre, të mbyllur në zarf, deri më 31 mars të çdo viti, pranë autoritetit ose strukturës përgjegjëse të institucionit publik, të parashikuar në shkronjën "b" të pikës 2 të nenit 41 të këtij ligji.

Për zyrtarët e përmendur në pikën 6 të këtij neni dhe kur ata nuk mbartin detyrimin për deklarim, pika 7 zbatohet për periudhën nga deklarimi i fundit deri në datën e largimit. Deklarimi kryhet jo më vonë se 15 ditë nga data e largimit nga funksioni.

Neni 16
**Informimi i publikut për deklarimet e interesave**

Deklaratat e interesave dhe çdo dokument tjetër i lidhur me to janë dokumente zyrtare. Publiku mund të vihet në dijeni për të dhënat që përftohen nga deklarimi, në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare".

Neni 17
**Verifikimi i deklaratës së interesave**

1. Verifikimi i deklaratës së interesave bëhet vetëm për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave, që përmbahen në deklaratë. Verifikimi përfshin përpunimin paraprak, kontrollin aritmetik e logjik, si dhe kontrollin e plotë, sipas të njëjtit kuptim metodologjik të këtyre termave, të përdorur në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë".

2. Kontrolli i plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratë kryhet:

a) çdo 2 vjet për zyrtarët e përcaktuar në nenet 27, 30 dhe 33 të këtij ligji;

b) çdo 3 vjet për zyrtarët e përcaktuar në nenin 29 (vetëm për kryetarët e bashkive ose të komunave me mbi 10 000 banorë dhe për kryetarët e këshillave të qarqeve); në nenet 31 e 32 (vetëm për zyrtarët e nivelit të lartë drejtues, të përcaktuar në këto dy nene); për prefektët, gjyqtarët e apelit, prokurorët e apelit dhe të Prokurorisë së Përgjithshme;

c) çdo 4 vjet për deputetët, për titullarët e institucioneve shtetërore, qendrore ose vendore, dhe anëtarët e organeve kolegjiale të këtyre institucioneve, të papërfshira në shkronjat e mësipërme të kësaj pike.

3. Për të gjitha kategoritë e tjera të zyrtarëve, që u nënshtrohen deklarimit periodik (përfshirë ato të përcaktuara në shkronjat e mësipërme të pikës 2), kontrolli kryhet çdo vit për një numër prej të paktën 4 për qind të numrit të përgjithshëm të deklaratave. Përzgjedhja e deklaratave bëhet me short, në prani të përfaqësuesve të sindikatave, të grupeve të ndryshme të zyrtarëve (nëse ekzistojnë), të medias, të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Përzgjedhja e një zyrtari/deklarate, në një vit, nuk e përjashton zyrtarin/deklaratën nga shorti për vitin pasardhës.

4. Për rastet e përcaktuara në pikën 2 shkronjat “a”, “b” e “c” dhe në pikën 3 të këtij neni duhet të shmanget kryerja e dyfishtë e kontrollit mbi të njëjtën deklaratë të të njëjtit zyrtar, të bërë në të njëjtin vit, përjashtuar rastet e pikës 5 të këtij neni.

5. Kontrolli ose rikontrolli i plotë i deklarimit kryhet çdo herë që gjykohet e nevojshme nga Inspektori i Përgjithshëm, kur ai ka të dhëna, nga burime të ligjshme, që vënë në dyshim vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave që përmbahen në deklarimin e një zyrtari, si dhe kur ka mospërputhje, që rezultojnë nga kontrolli aritmetik e logjik, të cilat tregojnë se burimet nuk mbulojnë ose nuk justifikojnë të drejtat pasurore të deklaruesit.

Neni 18

**Hetimi administrativ**

l. Kur nga rezultatet e verifikimit të deklarimit rezulton se burimet nuk mbulojnë apo justifikojnë pasuritë ose kur për një deklaratë, pavarësisht nëse ka kaluar apo jo në kontroll të plotë, ka të dhëna, nga burime të ligjshme, për fshehje të interesave dhe të çdo të dhëne tjetër private, që është e detyrueshme të deklarohet, ose deklarime të rreme, Inspektori i Përgjithshëm mund të nisë hetimin administrativ.

2. Mbledhja e të dhënave, kryerja e kontrollit të plotë dhe hetimi administrativ bëhen në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

Seksioni 3

**Dispozita të përbashkëta për të dyja sistemet e identifikimit dhe të regjistrimit të interesave**

Neni 19

**Lidhja ndërmjet dy sistemeve të identifikimit dhe regjistrimit të interesave**

Sistemi rast për rast dhe ai periodik i identifikimit dhe i regjistrimit të interesave ndërtohen dhe zbatohen në forma dhe mjete të tilla, që ndihmojnë njëri-tjetrin për:

a) parandalimin sa më të frytshëm të konfliktit të interesave;

b) mundësinë për informim sa më të plotë e më të lehtë të publikut me të dhënat e regjistruara të interesave.

Neni 20

**Mbrojtja për dhënien e informacioneve**

Çdo zyrtar apo çdo subjekt, i cili ofron informacion të bazuar për rastet e konfliktit të interesave të padeklaruara nga subjektet e këtij ligji, përfiton, sipas rastit, një mbrojtje të veçantë administrative, si më poshtë:

a) zyrtari, për të cilin jepet informacion, nuk mund të ushtrojë asnjë kompetencë administrative me efekte ndëshkuese mbi subjektin informues dhe as të bëhet pengesë për fitimin e të drejtave të ligjshme nga ky i fundit për shkak të dhënies së informacionit;

b) kur marrja e masës ndaj subjektit që informon përcaktohet nga një shkak tjetër ligjor, ajo merret vetëm nga një zyrtar, që qëndron në marrëdhënie varësie vertikale mbi zyrtarin, për të cilin është dhënë informacioni, me përjashtim të rastit kur marrja e masës administrative bëhet në kushtet e nenit 37 pika 6 të këtij ligji.

KREU III

KUFIZIMI I INTERESAVE PRIVATË PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTEVE TË

INTERESAVE NË ÇËSHTJE DHE RASTE TË VEÇANTA

Seksioni 1
**Kufizime të interesave privatë të zyrtarit për parandalimin e konfliktit rast për rast të interesit për çështje të veçanta**

Neni 21
**Ndalimi i lidhjes së kontratave**

1 . Nuk mund të lidhë kontratë me asnjë institucion publik:

a) asnjë person fizik, sipas rastit, në kuptimin civil ose tregtar, kur ai përkon me një person, i cili është zyrtar në funksionet e përcaktuara në seksionin 2 të këtij kreu;

b) asnjë shoqëri tregtare, ortakëri ose shoqëri e thjeshtë, në lidhje me të cilën zyrtari, që u përket kategorive të përmendura në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij neni, zotëron, në mënyrë aktive ose pasive, aksione ose pjesë në kapital në çfarëdo sasie.

2. Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit ose nënkryetarit të bashkisë, komunës ose këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues i një njësie të qeverisjes vendore, sipas kuptimit relativ të këtij termi për këto njësi, ndalimi i kontratave, sipas shkronjave "a" dhe "b" të pikës l të këtij neni, zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave me bashkinë, komunën ose qarkun, ku ushtron funksionet zyrtari, si dhe në rastin e lidhjes së kontratave me institucione publike, në varësi të bashkisë, komunës ose qarkut. Për këta zyrtarë dhe për kufizimin e kësaj pike, në kuptim të shkronjës "b" të pikës 1 të këtij neni, ndalimi zbatohet për çdo sasi të zotërimit të aksioneve ose pjesëve në kapital dhe për çdo nivel të ardhurash të përgjithshme bruto vjetore të shoqërisë.

3. Pavarësisht përcaktimeve në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, nuk mund të lidhet kontratë ndërmjet institucionit publik, në të cilin ushtron funksionet zyrtari dhe çdo institucioni publik, në varësi të këtij institucioni nga njëra anë, dhe një personi fizik, civil ose tregtar, ose person juridik, si dhe çdo ortakëri ndërmjet këtyre personave, nga ana tjetër, kur:

a) zyrtari ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese në vlerësimin e ofruesve dhe të ofertave dhe përcaktimin e termave të kontratës;

b) zyrtari ka interesa privatë, sipas përcaktimeve të nenit 37 të Kodit të Procedurave Administrative dhe/ose të nenit 709 të Kodit Civil.

4. Nga ndalimet e pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni përjashtohen rastet kur lidhja e kontratës:

a) ka të bëjë me punësimin e vetë zyrtarit në institucion publik ose me statusin e tij ligjor;

b) ka të bëjë me marrjen nga zyrtari të një shërbimi, që ofrohet nga institucioni publik ose organizmat dhe subjektet e krijuara a nën kontrollin e institucionit publik, kur këto shërbime janë të parashikuara në objektin e veprimtarisë së institucionit publik, si dhe me kushtin që shërbimi nuk i jepet zyrtarit në mënyrë favorizuese apo si trajtim preferencial në raport me të tjerët;

c) bazohet në ligje të veçanta, për qëllime publike, ose për trajtime të posaçme të kategorive të ndryshme të zyrtarëve;

ç) është e domosdoshme për kryerjen e funksionit publik dhe nuk ka alternativë tjetër;

d) ka të bëjë me një dhuratë, favor ose trajtim preferencial, në çdo rast pa kundërshpërblim, që subjektet e përcaktuara në pikën 1 shkronjat "a" dhe "b" dhe në pikën 2 të këtij neni, bëjnë në favor të një institucioni publik.

5. Për rastin përjashtimor të shkronjës "ç" të pikës 4 të këtij neni, institucioni publik, që lidh kontratën, sipas ligjeve dhe akteve nënligjore që rregullojnë funksionimin e tij:

a) kërkon pëlqimin e institucionit më të afërt epror;

b) njofton Inspektoratin e Lartë dhe e bën këtë kontratë publike në mungesë të institucionit apo kur marrja e pëlqimit bie ndesh me parimin e pavarësisë së institucioneve.

6. Për zyrtarët e përcaktuar në nenin 30 të këtij ligji:

a) ndalohet lidhja e kontratave ndërmjet këtij zyrtari, qoftë si person civil ose fizik

tregtar, si dhe çdo personi, në raport me të cilin zyrtari ka interes të llojit, të përcaktuar në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “i” (deri në shkallë të dytë) dhe "e" të pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji, nga njëra anë dhe operatorëve-subjekteve tregtare, që ushtrojnë veprimtari në sferën e juridiksionit ose të ndikimit të këtij autoriteti, nga ana tjetër;

b) përjashtohen nga ky ndalim kontratat që lidhen me marrjen e shërbimeve nga ana e zyrtarit ose e personave të lidhur nga këta operatorë dhe furnizimet që personat e lidhur mund t'u japin këtyre operatorëve, por me kusht që shërbimi nuk i jepet zyrtarit ose personave të lidhur me të ose furnizimi i këtyre të fundit nuk bëhet në mënyrë apo trajtim të veçantë ose individualisht preferencial, për shkak të kësaj lidhjeje, në raport me përfituesit dhe/ose klientët e tjerë. Nëse një kontratë lidhet në përputhje me këtë lejim, kërkohet gjithnjë paraprakisht moskundërshtimi i entit rregullator përkatës, bazuar në një kërkesë zyrtare dhe të argumentuar, si dhe kontrata bëhet kurdoherë publike nga vetë enti rregullator. Mungesa e një përgjigjeje brenda 30 ditëve nga ana e entit rregullator konsiderohet moskundërshtim.

Neni 22
**Ndalime në sigurimin e të ardhurave për shkak të funksionit të veçantë**

1. I ndalohet që të zotërojë, në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital, si dhe çdo lloj përfitimi tjetër, që nuk buron nga zotërimi pasiv, nga shoqëritë tregtare, që janë të përjashtuara ose të lehtësuara nga detyrimet doganore ose tatimore, si dhe kur këto shoqëri ushtrojnë veprimtari në zonat e lira, çdo zyrtari që ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese në dhënien shoqërisë të secilit prej trajtimeve të sipërpërmendura.

2. Zyrtarit, që është përfaqësues i një institucioni publik në zotërimin e aksioneve ose të pjesëve në kapital të shoqërive tregtare, gjatë ushtrimit të këtij funksioni i ndalohet:

a) marrja drejtpërdrejt ose tërthorazi, me ndërmjetësimin e palëve të treta, e çdo përfitimi financiar, përfshirë krijimin e një burimi të ardhshëm financiar, që lidhet ose përftohet për shkak të detyrës së tij si përfaqësues;

b) pranimi, në favor të tij, i dhuratave ose pjesëve në kapital nga shoqëria, anëtarët ose organet e saj;

c) blerja e pjesëve në kapital, aksioneve ose pasurive të këtyre shoqërive;

ç) përfitime të drejtpërdrejta ose të tërthorta nga furnizues a klientë të këtyre shoqërive.

Neni 23
**Ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale**

1. Është e ndaluar që një zyrtar të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat, kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesi të çdo lloji.

2. Përjashtohen vetëm rastet e përcaktuara me akte të organeve kompetente, të cilat lejojnë pranimin e dhuratave apo trajtimeve preferenciale për arsye protokollare.

3. Zyrtari, të cilit i janë ofruar dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet:

a) t'i refuzojë ato dhe, në rast se ofrimi është kryer pa dijeninë e tij ose paraprakisht, t'ia kthejë mbrapsht ofruesit ose, në pamundësi, t'ia dorëzojë zyrtarisht eprorit ose institucionit më të afërt epror;

b) të përpiqet të identifikojë personin që i ofron ato, motivet dhe interesat e tij;

c) të informojë, në çdo rast dhe menjëherë, eprorin ose institucionin më të afërt epror për

dhuratën, favorin, premtimin ose trajtimin preferencial të ofruar apo të dhënë, identitetin e ofruesit, kur ky është i identifikueshëm, rrethanat, si dhe të japë gjykimin për arsyet e mundshme të kësaj ngjarjeje e për lidhjen e saj me detyrat e tij si zyrtar;

ç) të vazhdojë normalisht ushtrimin e detyrës, sidomos për problemin për të cilin është ofruar dhurata, favori, premtimi ose trajtimi preferencial dhe të mbajë vazhdimisht në dijeni eprorin për çdo zhvillim të mundshëm;

d) në rast se ofrimi ose dhënia e të mirave të sipërpërmendura lidhen me kryerjen e një vepre penale, ta raportojë atë tek organet kompetente për ndjekje penale.

Neni 24
**Kufizimi i interesave të personave të lidhur me zyrtarin**

1. Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të ndalimeve të përcaktuara në nenin 21 pikat 1, 2 e 6 dhe në nenin 22 të këtij ligji, përbëhet nga bashkëshorti/ja, fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es.

2. Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të nenit 23 të këtij ligji, përveç atyre të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, zgjerohet edhe me çdo person fizik ose juridik, i cili, në lidhje me dhuratën, favorin, premtimin ose trajtimin preferencial, luan rolin e ndërmjetësit a të shkëmbyesit të interesave të lindur nga ky veprim.

3. Ndalimet dhe kufizimet për zyrtarin, të përcaktuara në këtë seksion, zbatohen edhe për personat e lidhur me të, në përputhje me pikat e mësipërme të këtij neni.

4. Kufijtë e zotërimit të aksioneve ose të pjesëve në kapital janë të njëjtë me ata të përcaktuar në nenin 21 të këtij ligji edhe:

a) për çdo person të lidhur me zyrtarin veç e veç;

b) për tërësinë e interesave të zyrtarit dhe të personave të lidhur me të;

c) për tërësinë e interesave të personave të lidhur me zyrtarin.

5. Ndalimet dhe kufizimet e këtij seksioni nuk zbatohen për personat e lidhur me personat e lidhur me zyrtarin.

Neni 25
**Zotërimi në mënyrë të tërthortë i interesave**

1. Me persona juridikë, të cilët përmenden në këtë seksion, nënkuptohen personat juridikë, rezidentë dhe jorezidentë në Republikën e Shqipërisë.

2. Ndalimi i lidhjes së kontratave, sipas çdo rasti të nenit 21 të këtij ligji, zbatohet edhe për ato shoqëri tregtare, ortakëri ose shoqëri të thjeshta që shfaqen si palë në lidhjen e një kontrate me një institucion publik, në të cilat shoqëritë tregtare, ortakëritë ose shoqëritë e thjeshta, të përmendura në nenin 21 pikat 1 shkronja "b" dhe 3 e 6 të këtij ligji, zotërojnë aksione ose pjesë në kapital.

Seksioni 2
**Kufizimi i interesave privatë për parandalimin e rasteve të veçanta të konfliktit të vazhdueshëm të interesave**

Neni 26
**Të përgjithshme**

1. Llojet dhe kufizimet e interesave privatë të kategorive të zyrtarëve, të përcaktuara në këtë seksion, nuk përjashtojnë llojet dhe kufizimet e përcaktuara në ligje të tjera për këto kategori zyrtarësh, të zbatuara për të njëjtin qëllim, por, në çdo rast, zbatohet kufizimi më i rreptë, në përputhje me përcaktimet e nenit 5 të këtij ligji.

2. Për zyrtarët e tjerë, të patrajtuar në këtë seksion, zbatohen kufizime të përcaktuara në

ligje të veçanta për të njëjtin qëllim.

Kur me ligj përcaktohet se këta zyrtarë nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari private, kjo kupton edhe ndalimin e zotërimit në mënyrë aktive të aksioneve ose pjesëve në kapital në shoqëritë tregtare në ato kushte për të cilat ndalohet veprimtaria private.

3. Me persona juridikë, të cilët përmenden në këtë seksion, kuptohen të gjithë personat juridikë, të regjistruar në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Kur zyrtari zotëron interesa të lidhur me persona fizikë ose juridikë, të regjistruar jashtë territorit të Republikës të Shqipërisë, që zotërojnë ose kontrollojnë një person juridik, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, dhe nga të cilët, në mënyrë të tërthortë, krijohen të drejta mbi këtë person, kufizimi i interesave të zyrtarit dhe/ose të personit juridik, të zotëruar ose të kontrolluar, zbatohet në atë masë, që ky veprim i tërthortë të japë të njëjtin rezultat.

Neni 27
**Kufizimet për anëtarin e Këshillit të Ministrave dhe zëvendësministrin**

Kryeministri, Zëvendëskryeministri, ministri dhe zëvendësministri:

a) nuk mund të jenë drejtues ose anëtarë të organeve drejtuese në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale dhe çdo organizate tjetër, përjashtuar organizatat politike dhe shtetërore, si dhe në rastet kur një pozicion i tillë diktohet për shkak të funksionit;

b) nuk mund të ushtrojnë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, si dhe profesione të lira të avokatisë, noterisë, ekspertit të licencuar, si dhe të konsulentit, agjentit a përfaqësuesit të organizatave të përcaktuara në shkronjën "a" të këtij neni, si dhe nuk mund të jenë të punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër;

c) nuk mund të zotërojnë në mënyrë aktive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë së saj.

Neni 28
**Kufizimet për deputetin**

Deputeti:

a) nuk mund të jetë drejtues ose anëtar i organeve drejtuese të organizatave fitimprurëse;

b) nuk mund të ushtrojë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, profesione të lira të avokatisë, noterisë, ekspertit të licencuar, si dhe të konsulentit, agjentit a përfaqësuesit të organizatave të përcaktuara në shkronjën "a" të këtij neni dhe nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër;

c) nuk mund të zotërojë, në mënyrë aktive, asnjë aksion ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, nëse ajo rezulton me pozitë dominuese në treg.

Neni 29
**Kufizimet për kryetarin e bashkisë, të komunës dhe të këshillit të qarkut**

Kryetari i bashkisë, i komunës dhe i këshillit të qarkut:

a) nuk mund të jenë drejtues ose anëtarë të organeve drejtuese të organizatave fitimprurëse, që ushtrojnë veprimtari brenda territorit të juridiksionit të tij;

b) nuk mund të ushtrojnë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, profesione të lira të avokatisë,

noterisë, ekspertit të licencuar, si dhe të konsulentit, agjentit a përfaqësuesit të organizatave, të përcaktuara në shkronjën "a" të këtij neni dhe nuk mund të jenë të punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër.

Neni 30
**Kufizimet për anëtarin e organit të autoritetit rregullator**

Për anëtarin e organit të një autoriteti rregullator ose të mbrojtjes së konkurrencës, përfshirë Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, Zëvendësguvernatorin dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të saj:

a) zbatohen të gjitha kufizimet dhe lejimet e përcaktuara në nenin 31 të këtij ligj;

b) zbatohet edhe kushti që një zyrtar i tillë nuk mund të zotërojë asnjë të drejtë, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, sipas kuptimit të nenit 25 pika 2 të këtij ligji, në raport me çdo subjekt, që ushtron veprimtari në sferën e juridiksionit ose të ndikimit të këtij autoriteti, përfshirë ndalimin e plotë të zotërimit, në mënyrë aktive apo pasive, të aksioneve në këto shoqëri.

Neni 31
**Kufizimet për zyrtarin e nivelit të lartë dhe të mesëm, drejtues të administratës publike, institucioneve të tjera publike, Policisë së Shtetit dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë**

Nëpunësi civil i nivelit të lartë e të mesëm drejtues, sipas përcaktimit të nenit 11 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", zyrtari i nivelit të lartë e të mesëm të Policisë së Shtetit dhe të Forcave të Armatosura, sipas sistemit të gradave dhe detyrave të zbatueshme për këto institucione publike, zyrtarët e nivelit të lartë dhe të mesëm, që barazohen me ata të nëpunësit civil në entet rregullatore (dhe ata sipas nenit 30 të këtij ligji) dhe në të gjitha institucionet e tjera publike, si dhe prefekti:

a) nuk mund të jenë drejtues në organizatat fitimprurëse;

b) nuk mund të jenë anëtarë në organet drejtuese të një shoqërie tregtare ose në një organizatë jofitimprurëse, kur këta ushtrojnë veprimtari në një sferë që përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit të zyrtarit dhe të kompetencës së tij për të vepruar, me akte të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, me akte të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këto shoqëri a organizata apo mbi shoqëri ose organizata të tjera që bashkëpunojnë ose konkurrojnë me shoqërinë në fjalë, përjashtuar rastet kur ky pozicion në shoqëri ose organizatë vjen për shkak të funksionit dhe/ose të statusit;

c) nuk mund të ushtrojnë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, profesione të lira të avokatisë, noterisë, ekspertit të licencuar, si dhe të konsulentit, agjentit a të përfaqësuesit të organizatave, të përcaktuara në shkronjën "a" të këtij neni, dhe nuk mund të jenë të punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër;

ç) mund të zotërojnë, në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, pa asnjë kufizim, me përjashtim të rastit kur shoqëria ushtron veprimtari në një sferë që përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit të zyrtarit dhe të kompetencës së tij për të vepruar, me akte të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këto shoqëri apo mbi shoqëri të tjera, që bashkëpunojnë ose konkurrojnë me shoqërinë në fjalë, rast në të cilin zyrtari mund të zotërojë aksione ose pjesë në kapital vetëm, në përputhje me kushtet e përcaktuara në shkronjën "c" të nenit 27 të këtij ligji.

Neni 32
**Kufizimet për zyrtarin e organit tatimor ose doganor**

Mbi zyrtarin e administratës doganore dhe tatimore, që merret drejtpërdrejt me mbledhjen e të ardhurave doganore ose tatimore, përveç kufizimeve, të përcaktuara në nenin 31 të këtij ligji, zbatohen edhe kufizimet e mëposhtme:

a) zyrtari i organit doganor nuk mund të zotërojë, në mënyrë aktive, asnjë aksion ose pjesë në kapital në shoqëritë tregtare, që kryejnë veprimtari import-eksporti;

b) zyrtari i organit tatimor nuk mund të zotërojë, në mënyrë aktive, asnjë aksion ose pjesë në kapital në shoqëritë tregtare, që shlyejnë detyrimet tatimore ose ushtrojnë veprimtari në fushën ose territorin e juridiksionit të degës së tatim-taksave, ku ushtron funksionet ky zyrtar. Për zyrtarët e organit drejtues qendror, territor i juridiksionit vlerësohet i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë.

Neni 33

**Kufizimet për disa zyrtarë të tjerë në funksione të larta shtetërore**

Presidenti i Republikës, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, gjyqtari i Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Avokati i Popullit, anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive nuk mund të zotërojnë aksione në mënyrë aktive ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, të çdo forme.

Neni 34

**Vlerësimi i pozitës dominuese në treg të një shoqërie**

1. Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, Autoriteti i Konkurrencës, në përputhje me ligjin nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, vlerëson me ose pa kërkesë, nëse një shoqëri ka pozitë dominuese në një treg.

2. Kur një shoqëri është cilësuar paraprakisht nga ky autoritet si një shoqëri me pozitë dominuese në treg, çdo zyrtar, epror, institucion publik dhe institucion epror e marrin këtë fakt si të mirëqenë.

3. Nëse një shoqëri, në të cilën një zyrtar zotëron aksione ose pjesë në kapital, nuk është cilësuar paraprakisht nga ky autoritet si një shoqëri me pozitë dominuese në treg, dhe kur eprori ose institucioni epror, në bazë të të dhënave zyrtare, gjykon se ka vend për një vlerësim të pozicionit në treg të kësaj shoqërie, i kërkon zyrtarisht Autoritetit të Konkurrencës vlerësimin për pozicionin e kësaj shoqërie. Kërkesa duhet të bashkëshoqërohet edhe me të dhëna të plota dhe të besueshme, në mënyrë që të lehtësohet procesi vlerësues i Autoritetit të Konkurrencës. Kur zyrtari, me të cilin lidhet çështja, është i interesuar, e bën kërkesën pranë Autoritetit të Konkurrencës, nëpërmjet institucionit publik, ku ai ushtron funksionet ose nëpërmjet institucionit epror.

4. Autoriteti i Konkurrencës, për nevojën e zbatimit të këtij ligji, është i detyruar të përgjigjet zyrtarisht në bazë të njohjes më të mirë, me një vlerësim pohues ose mohues, sa herë që kjo i kërkohet nga një institucion publik, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 1 muaj nga data e marrjes së kërkesës. Për arsye të përligjura, Autoriteti i Konkurrencës mund ta shtyjë afatin dhe të përcaktojë një afat të mundshëm të kthimit të përgjigjes, duke e njoftuar për këtë kërkuesin.

5. Deri në marrjen e një përgjigjeje përfundimtare nga Autoriteti i Konkurrencës, zyrtari vazhdon të gëzojë të drejtat e tij sikur kjo pozitë dominuese të mos ekzistonte, por kjo nuk duhet ta pengojë zyrtarin, eprorin ose institucionin epror të marrë të gjitha masat alternative parandaluese e të përshtatshme, sipas përcaktimeve të nenit 37 të këtij ligji, me qëllim që t'i paraprijnë mundësisë së vlerësimit si një shoqëri me pozitë dominuese në treg.

Neni 35

**Prania e interesave në personat e lidhur me zyrtarin**

1. Person i lidhur, për qëllim të neneve 27 deri 33 të këtij ligji, për kufizimet e interesave privatë të zyrtarëve, të përcaktuar në nenet e tjera të këtij seksioni, janë vetëm bashkëshorti/ja, fëmijët në moshë madhore, prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es.

2. Në rast se aksionet apo pjesët në kapital janë të regjistruara në emrin e personit të lidhur, ato vlerësohen njëlloj si të ishin të regjistruara në emër të vetë zyrtarit dhe personit të lidhur i kufizohen të drejtat pasurore për to, në të njëjtën masë dhe mënyrë si në rastin e vetë zyrtarit. Këto kufizime nuk zbatohen për personat e lidhur me personat e lidhur me zyrtarin.

3. Kufizimi i pikës 2 të këtij neni zbatohet njëlloj dhe respekton të njëjtët kufij edhe për rastet e mëposhtme:

a) tërësinë e aksioneve ose të pjesëve në kapital të zyrtarit dhe të personave të lidhur me të;

b) tërësinë e aksioneve ose të pjesëve në kapital të personave të lidhur me zyrtarin.

4. Personi i lidhur me një zyrtar nuk mund të ushtrojë veprimtari si person fizik tregtar ose ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, nëse veprimtaria përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit të zyrtarit dhe të kompetencës së tij për të vepruar, me akte individuale apo normative të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këtë person fizik apo mbi shoqëri tregtare e persona të tjerë fizikë, që bashkëpunojnë ose konkurrojnë me personin e lidhur. Kjo pikë nuk zbatohet kur plotësohen të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

a) mjeti i vetëm, me të cilin ky zyrtar mund të krijojë efektet e mësipërme, është një ligj ose një vendim i këshillit të bashkisë, komunës ose qarkut ose një vendim gjyqësor;

b) veprimtaria dhe/ose disa veprimtari tregtare së bashku të një personi të lidhur krijon një të ardhur të përgjithshme bruto vjetore më pak se 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë.

Neni 36

**Lidhjet ndërmjet interesave dhe konflikteve të seksioneve 1 dhe 2**

1. Edhe kur një zyrtar zotëron interesa privatë brenda kufijve të lejuar të seksionit 2 të këtij kreu, apo i sjell ata brenda kufijve të lejuar sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 38 të këtij ligji, ai nuk është i çliruar nga detyrimet, kufizimet ose ndalimet e tjera të këtij kreu, si dhe nuk është i çliruar a priori nga rreziku i rënies në konflikt rast për rast ose të vazhdueshëm të interesit.

2. Zotërimi pasiv i aksioneve ose i pjesëve në kapital mund të përbëjë shkak për rënien në konflikt rast për rast të interesit. Zyrtari dhe personi i besuar janë bashkëpërgjegjës për të marrë të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e rënies së zyrtarit në një konflikt të tillë dhe komunikojnë ndërmjet tyre, për aq sa është e nevojshme, për këtë qëllim. Barra e provës për pamundësinë e komunikimit, në kohën e përshtatshme, në raport me pjesëmarrjen në vendimmarrje të zyrtarit, bie mbi zyrtarin dhe personin e besuar.

KREU IV

MËNYRAT E TRAJTIMIT DHE TË ZGJIDHJES SË KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Neni 37

**Mënyrat bazë të trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave**

Për parandalimin sa më të hershëm dhe sa më efikas të çdo konflikti interesi, të çdo lloji qoftë ai:

1. Zyrtari, në ushtrimin e funksioneve të tij, paraprakisht, sipas rrethanës, nevojës, në mënyrë të shkallëzuar ose në proporcion me rëndësinë e situatës, mënjanon dhe zgjidh vetë çdo situatë të konfliktit të interesit, të çdo forme qoftë ajo, duke përdorur, sipas rastit dhe

përshtatshmërisë, një apo disa nga mënyrat e mëposhtme:

a) duke transferuar a tjetërsuar interesat privatë;

b) duke u vetëpërjashtuar paraprakisht nga procesi konkret i vendimmarrjes, me përjashtim të rasteve kur është e pamundur delegimi i kompetencave të zyrtarit te një zyrtar tjetër, për shkak të ligjit apo për shkak të situatës;

c) duke dhënë dorëheqjen nga detyrat, funksionet apo angazhimet private, që janë në konflikt me funksionin e tij publik;

ç) duke dhënë dorëheqjen nga funksioni publik, veçanërisht në kushtet e lindjes së konflikteve të vazhdueshme të interesit.

2. Zyrtari njofton eprorin ose institucionin epror, sipas rastit, për zgjidhjen e sugjeruar ose të marrë dhe provon e dokumenton këtë zgjidhje.

3. Pavarësisht zbatimit të pikave 1 dhe 2 të këtij neni, zyrtari nuk çlirohet nga përgjegjësia e rënies në konflikt interesi, kur masat e marra nga vetë ai nuk rezultojnë të frytshme në parandalimin dhe shmangien e konfliktit të interesit.

4. Eprori i zyrtarit ose institucioni epror, duke filluar nga ai më i afërt, paraprakisht, sipas rrethanës, nevojës, në mënyrë të shkallëzuar ose në proporcion me rëndësinë e situatës, mënjanon dhe zgjidh çdo situatë të konfliktit të interesit të një zyrtari vartës, të çdo forme qoftë ajo, duke përdorur, sipas rastit dhe përshtatshmërisë, një apo disa nga mënyrat e mëposhtme:

a) t'i kufizojë zyrtarit informacione të caktuara, që lidhen me ushtrimin e funksionit të tij;

b) të mos i ngarkojë zyrtarit detyra që mund të çojnë në shfaqjen e një konflikti interesash;

c) të mos lejojë që zyrtari të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes;

ç) të rishikojë ose të ndryshojë detyrat dhe kompetencat e zyrtarit;

d) ta transferojë zyrtarin në një detyrë tjetër, që shmang konfliktin e interesave;

dh) të marrë masat e nevojshme për të shmangur emërimin ose zgjedhjen e një zyrtari në funksione, në të cilat mund të lindin ose ka konflikte interesash;

e) në rast të një akti të marrë në praninë e konfliktit faktik të interesit, në çdo mënyrë që kjo vihet re, të anulojë ose të revokojë, nëse e ka këtë kompetencë, aktet e marra nga zyrtari, sa më parë që të jetë e mundur, dhe mundësisht para se ato të kenë sjellë pasoja;

ë) anulimi ose revokimi i aktit mund të bëhet edhe kur gjykohet se akti është marrë në kushtet e konfliktit në dukje të interesit, i cili mund të shfaqet rast për rast ose në mënyrë të vazhdueshme;

f) anulimi ose revokimi i një akti nuk bëhet nga eprori kur ai vlerëson se pasojat që mund të vijnë nga anulimi ose revokimi i tejkalojnë dukshëm përfitimet nga ky anulim ose revokim.

5. Në raste të veçanta kur:

a) konflikti i interesit lidhet me drejtuesin më të lartë të një institucioni publik, trajtimi dhe zgjidhja bëhen nga institucioni epror, nëse ka të tillë dhe kjo nuk cenon parimin e pavarësisë së institucioneve;

b) konflikti lidhet me një zyrtar që njësohet ose është anëtar i një organi kushtetues, trajtimi dhe zgjidhja bëhet nga organet kompetente të përcaktuara në Kushtetutë.

6. Zyrtari lejohet të ushtrojë funksion dhe të kryejë detyrën me kusht që konflikti i vetëm i interesit i pashmangshëm është ai në dukje kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) kur ai:

i) ose është i pazëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve;

ii) ose vetëpërjashtimi i tij është i pamundur, sipas shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni;

iii) ose asnjëra nga zgjidhjet e pikës 4 të këtij neni nuk është e mundur;

b) dhe kur:

i) vendimet e tij, sipas rregullimeve me ligj, nuk i nënshtrohen miratimit, revokimit ose shfuqizimit nga një institucion epror;

ii) nuk është i mundur as tjetërsimi i interesit privat, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij

neni, për shkak të natyrës së tij (si lidhje familjare, komunitare etj.);

iii) nuk ka kuptim, që për një rast konflikti të tillë, ai të japë detyrimisht dorëheqjen nga funksioni.

Në një rast të tillë, vendimet e këtij zyrtari i nënshtrohen një kontrolli dhe vlerësimi të veçantë nga institucionet e ngarkuara me ligj për të kryer kontrollin e këtyre vendimeve. Vendimi dhe rezultatet e kontrollit bëhen kurdoherë publike.

7. Eprori njofton me shkrim dhe në mënyrë të arsyetuar zyrtarin në konflikt interesi, si dhe eprorin e vet ose institucionin epror për zgjidhjen e dhënë.

8. Pavarësisht nga zbatimi i pikave 1 e 2 të këtij neni nga vetë zyrtari dhe/ose i pikave 4, 5 e 6 të këtij neni nga eprori ose institucioni epror, zyrtarët përgjegjës, për parandalimin dhe shmangien e konfliktit konkret të interesit, nuk çlirohen nga përgjegjësia, kur masat e marra nuk rezultojnë të frytshme në parandalimin dhe shmangien e tij.

9. Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesit, sipas këtij neni, duhet të bëhen bazuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet zyrtarit dhe eprorit ose institucionit epror, duke synuar së bashku përdorimin e mënyrës më të mirë për parandalimin dhe zgjidhjen e gjendjes me konflikt interesi.

Neni 38

**Zgjidhja e rasteve të veçanta të konfliktit të vazhdueshëm të interesave**

1. Për kategoritë e zyrtarëve, të përcaktuara në kreun III seksioni 2 të këtij ligji, kur trajtimi dhe zgjidhja e konfliktit të vazhdueshëm të interesit nuk mund të arrihet nëpërmjet mënyrave të dhëna në nenin 37 të këtij ligji, që zyrtari të vazhdojë të qëndrojë në të njëjtin funksion, duhet detyrimisht:

a) të heqë dorë nga funksionet drejtuese ose të anëtarësisë në organet drejtuese në çdo rast që kjo i ndalohet, sipas kreut III seksioni 2 të këtij ligji, sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 15 ditë nga çasti i lindjes së këtij detyrimi dhe të njoftojë e të dokumentojë këtë fakt menjëherë dhe jo më vonë se 10 ditë nga kryerja e tij;

b) të ndërpresë, brenda 30 ditëve, ushtrimin e veprimtarive të ndaluara, sipas kreut III seksioni 2 të këtij ligji, dhe brenda këtij afati, por sa më parë, t'u kërkojë organeve kompetente çregjistrimin sipas ligjit të këtyre veprimtarive. Zyrtari njofton dhe dokumenton përmbushjen e këtyre detyrimeve menjëherë, por jo më vonë se 10 ditë nga afati i mësipërm, si dhe njofton dhe dokumenton çregjistrimet e kryera nga organet kompetente në çdo kohë dhe menjëherë, sapo ato të jenë kryer;

c) të transferojë të drejtat e zotërimit aktiv të aksioneve apo të pjesëve në kapital që zotëron te një person tjetër, sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 3 të këtij ligji, por që:

i) personi i besuar nuk mund të jetë bashkëshorti/ja dhe prindërit e tij/saj, fëmijët në moshë madhore dhe bashkëshortët e tyre, prindërit e zyrtarit, vëllezërit dhe motrat e tij dhe bashkëshortët e tyre, personat me miqësi të njohur me këtë zyrtar, një zyrtar apo person tjetër me lidhje varësie, qoftë edhe të tërthortë, për shkak të funksionit publik me zyrtarin në fjalë;

ii) personi i besuar nuk mund të jetë një person fizik tregtar, qoftë njëri nga personat e sipërpërmendur, një shoqëri, ku zyrtari zotëron, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, sipas kuptimit të nenit 25 të këtij ligji, aksione a pjesë në kapital, një organizatë jofitimprurëse, në të cilën zyrtari ka pasur ose ka marrëdhënie interesi të çfarëdo lloji.

2. Nëse zyrtari heq dorë nga të gjitha të drejtat e pronësisë mbi aksionet ose pjesët në kapital dhe i tjetërson ato te një person tjetër, ky i fundit nuk mund të jetë asnjë nga subjektet e përmendura në shkronjën "c" të pikës 1 të këtij neni për personin e besuar. Zyrtari duhet ta njoftojë dhe ta dokumentojë këtë veprim menjëherë, por jo më vonë se 15 ditë nga kryerja e tij.

3. Transferimi, sipas shkronjës "c" të pikës 1 të këtij neni, ose tjetërsimi, sipas pikës 2 të këtij neni, kryhet sa më parë që të jetë e mundur, por jo më vonë se 2 muaj nga çasti i lindjes së

detyrimit. Zyrtari njofton dhe dokumenton përmbushjen e këtij detyrimi menjëherë, por jo më vonë se 15 ditë nga kryerja e këtij veprimi.

Personi i besuar i një zyrtari të përcaktuar në nenin 30 të këtij ligji, tjetërson, sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 6 muaj, aksionet ose pjesët në kapital, të zotëruara në mënyrë pasive nga ky zyrtar, me qëllim respektimin e kufizimeve të interesave të këtij zyrtari, sipas nenit 30 të këtij ligji. Personi i besuar njofton për përmbushjen e këtij detyrimi njësoj si në rastin e zyrtarit.

4. Afatet e përcaktuara në pikat e mësipërme të këtij neni mund të shtyhen nga eprori ose institucioni epror, kur zyrtari paraqet shkaqe të arsyeshme për vonesën. Në çdo rast, arsyet e shtyrjes dhe afatet e reja regjistrohen dhe dokumentohen, por këto afate nuk mund të jenë asnjëherë më shumë se dyfishi i afateve të përcaktuara më sipër, me përjashtim të rasteve kur shtyrja diktohet nga afatet procedurale të detyrueshme, të përcaktuara nga Kushtetuta, nga ligjet procedurale, legjislacioni tregtar, dhe/ose nga rregulloret e institucioneve publike për lëshimin e dokumenteve zyrtare dhe/ose kryerjen e veprimeve juridike, ose kur afati shtyhet për shkak të nevojës së Autoritetit të Konkurrencës, për të vlerësuar pozitën dominuese në treg të një shoqërie.

5. Me zhdukjen e shkaqeve që diktojnë kufizimet e përcaktuara në kreun III seksioni 2 të këtij ligji, zyrtari mund të gëzojë përsëri këto të drejta.

6. Ky nen zbatohet për aq sa i takon edhe për personin e lidhur me zyrtarin, sipas përcaktimeve të nenit 35 të këtij ligji.

7. Nëse zyrtari ose personi i lidhur nuk është i gatshëm të zbatojë kërkesat e pikave të këtij neni, atëherë zyrtari është i detyruar të japë dorëheqjen nga funksioni, brenda afateve të përcaktuara në këtë nen.

8. Nëse dorëheqja nuk jepet brenda afateve të përcaktuara në këtë nen, eprori ose institucioni më i afërt epror, sipas radhës, zbaton njërën apo disa nga mënyrat e përcaktuara në shkronjat "ç" dhe/ose "d" të pikës 4 të nenit 37 të këtij ligji, e cila mundëson zgjidhjen më të frytshme, jo më vonë se 10 ditë nga afati përfundimtar, me përjashtim të rasteve kur ky veprim nuk është i mundur ose ky afat nuk mund të respektohet, për shkak të afateve të tjera procedurale, sipas përcaktimeve të nenit 39 të këtij ligji.

Neni 39

**Procedurat për trajtimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave**

1. Kompetencat e eprorëve ose të institucioneve eprore për trajtimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave, përfshirë ndalimet ose kufizimet, sipas kreut III të këtij ligji, zgjidhja e të cilave bëhet sipas mënyrave të dhëna në nenet 37 e 38 të këtij ligji dhe procedurat për ushtrimin e këtyre kompetencave përcaktohen nga:

a) Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi i Procedurës Penale, për proceset gjyqësore dhe procedimet penale;

b) Kodi i Procedurave Administrative për të gjitha institucionet publike, që i nënshtrohen këtij Kodi;

c) ligje të veçanta, që rregullojnë veprimtarinë e institucioneve publike ose të drejtat dhe detyrimet e kategorive të ndryshme të zyrtarëve;

ç) Kushtetuta, kur konflikti lidhet me një zyrtar, që njësohet ose është anëtar i një organi kushtetues.

2. Procedurat dhe kompetencat, sipas pikës 1 të këtij neni, sipas rastit, përcaktojnë edhe mënyrën se si vetë zyrtari ose personi i lidhur me të, ndaj të cilit janë zbatuar masat për trajtimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave, mund të ankohet kur e gjykon se këto masa janë marrë në tejkalim të përcaktimeve të këtij ligji.

KREU V
PAVLEFSHMËRIA E AKTEVE TË MARRA NË KUSHTET
E KONFLIKTIT TË INTERESAVE DHE PASOJAT

Neni 40
**Pavlefshmëria e akteve dhe pasojat**

1. Aktet dhe kontratat administrative të çdo institucioni publik dhe ankimimi ndaj tyre, të nxjerra në kushtet e konfliktit faktik ose në dukje të interesave, janë të pavlefshme, sipas kuptimit të këtij termi dhe parimeve e procedurave të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

2. Çdo kontratë civile, e lidhur në kundërshtim me pikat 1, 2 e 3 të nenit 21 të këtij ligji, ose në çdo rast tjetër, kur ajo është lidhur në praninë e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nuk krijon asnjë pasojë juridike.

3. Aktet e përcaktuara në shkronjën "a", "ii" të pikës 1 të nenit 4 të këtij ligji, të nxjerra në praninë e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, rishihen dhe rrëzohen për këtë shkak nga organi përkatës, në përputhje me kompetencat e tij për të vendosur në lidhje me këtë çështje, sipas përcaktimeve dhe sipas rastit, në Kodin e Procedurës Civile ose në Kodin e Procedurës Penale apo në ligje të tjera, që rregullojnë regjimin e këtyre akteve.

4. Aktet e përcaktuara në shkronjën "a" "iii" të pikës 1 të nenit 4 të këtij ligji, të nxjerra në praninë e konfliktit faktik të interesit, janë relativisht të pavlefshme, sipas të njëjtit kuptim të përdorur për aktet administrative në Kodin e Procedurave Administrative.

5. Konflikti në dukje i interesit nuk përbën shkak për pavlefshmëri, sipas pikave 1 e 3 të këtij neni, vetëm nëse ai shfaqet në kushtet e përcaktuara në pikën 6 të nenit 37 të këtij ligji.

6. Kur një akt i një institucioni publik bëhet i pavlefshëm, sipas përcaktimeve të pikave 1, 2, 3 e 4 të këtij neni:

a) institucioni publik, kur gjykon se zyrtari ka vepruar me keqbesim:

i) ndërmerr procedurat e dënimit disiplinor ndaj zyrtarit, shkaktar i pavlefshmërisë së aktit;

ii) përdor të gjitha mjetet ligjore për kalimin e barrës së dëmshpërblimit te ky zyrtar;

iii) i kërkon gjykatës përkatëse edhe vendosjen e një shpërblimi në favor të institucionit për dëmin moral të shkaktuar;

iv) bën kallëzim penal ndaj zyrtarit, nëse gjykon se shkelja e kryer nga ai përbën vepër penale;

b) në rastin kur vetë institucioni publik nuk e merr këtë nismë, sipas shkronjës "a" të kësaj pike, institucioni epror, duke filluar nga ai më i afërti e me radhë, sipas kompetencave ligjore, zbaton detyrat e përcaktuara në shkronjën "a" të kësaj pike. Në mungesë të veprimit të tyre, detyrat e përcaktuara në shkronjën "a" të kësaj pike zbatohen nga Inspektorati i Lartë në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit;

c) përcaktimet e shkronjës "a" të kësaj pike mund të zbatohen edhe ndaj çdo zyrtari tjetër përgjegjës, që me veprimet apo mosveprimet e veta nuk ka parandaluar konfliktin e interesit, shkak për pavlefshmërinë e aktit, ose për moszbatimin e detyrimeve, sipas shkronjës "a" të kësaj pike;

ç) përcaktimet e shkronjës "a" të kësaj pike zbatohen për zyrtarin në konflikt interesi, shkak të pavlefshmërisë së aktit, sipas rasteve të mëposhtme:

i) në rastin e deputetit, për votën e dhënë si deputet zbatohet vetëm shkronja "a" "i" e kësaj pike;

ii) në rastin e gjyqtarit, për vendimet gjyqësore të marra prej tij ose për votën e tij në një vendim gjyqësor, nuk zbatohet shkronja "a" "ii" e "iii" të kësaj pike;

iii) në rastin e prokurorit, në ushtrim të detyrës, nuk zbatohet shkronja "a" "ii" e "iii" të kësaj pike;

d) për zyrtarët e tjerë, që ushtrojnë funksione kontrolli ose hetimi, përcaktimet e shkronjës “a” “ii” e “iii” të kësaj pike nuk janë të detyrueshme, por vlerësimi i tyre i mbetet eprorit dhe, në mungesë apo mosveprim të tij, institucionit epror.

7. Veprimet e përcaktuara në pikën 6 të këtij neni kryhen nga institucioni publik, sipas rastit, edhe kundër personit të lidhur, personit të besuar ose çdo personi tjetër bashkëpërgjegjës.

## KREU VI
## INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE

### Neni 41
### **Autoritetet përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave**

1. Autoriteti qendror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe që përmendet në këtë ligj me shkurtimin “Inspektorati i Lartë”.

2. Autoriteti ose strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji në institucionet publike janë:

a) eprorët e zyrtarëve, sipas hierarkisë, brenda një institucioni publik;

b) drejtoritë, njësitë e burimeve njerëzore apo njësi të ngarkuara a të ngritura posaçërisht, sipas nevojës dhe mundësive të çdo institucioni publik;

c) institucionet eprore.

### Neni 42
### **Kompetencat e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive**

1. Inspektorati i Lartë, me cilësinë e autoritetit qendror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji, kryen detyrat dhe ka përgjegjësitë e mëposhtme:

a) drejtimin dhe përmirësimin e politikave dhe të mekanizmave të parandalimit dhe shmangies së konfliktit të interesave;

b) ofrimin e asistencës teknike për këshillimin dhe mbështetjen e nismave ligjore dhe nënligjore, të ndërmarra nga institucionet publike, për parandalimin e konfliktit të interesave;

c) ofrimin e rekomandimeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, për vlerësimin e projektligjeve, që kanë të bëjnë me çështjen e konfliktit të interesave, kur kjo kërkohet nga ky institucion;

ç) forcimin e kapaciteteve për administrimin e konfliktit të interesave në institucionet publike;

d) monitorimin, kontrollin dhe vlerësimin e përputhshmërisë së akteve nënligjore dhe të rregulloreve të brendshme, të miratuara nga institucionet publike për konfliktin e interesave, me parimet dhe detyrimet e këtij ligji;

dh) monitorimin, kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të këtij ligji, në tërësi, për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet publike, si dhe të respektimit të këtij ligji, në raste të veçanta të konfliktit të interesave;

e) regjistrimin periodik të interesave privatë të zyrtarëve, sipas kreut II seksioni 2 të këtij ligji;

ë) përcaktimin e modelit të deklarimit rast për rast të interesave, si dhe të regjistrimit të të dhënave që lidhen me një konflikt të tillë;

f) këshillimin e zyrtarëve të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprore, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave dhe për çështje të etikës të lidhura

me to, si dhe për regjistrimin periodik të interesave;

g) verifikimin dhe hetimin administrativ të deklarimeve periodike të interesave;

gj) verifikimin dhe hetimin administrativ të konfliktit rast për rast të interesave, si dhe të ndalimeve e kufizimeve të interesave të përcaktuar në kreun III të këtij ligji, me kërkesë të institucionit publik a epror ose kur e gjykon të nevojshme edhe me nismën e tij;

h) vendosjen e masave administrative ndëshkuese në kompetencë të tij, sipas përcaktimeve në këtë ligj;

i) çdo kompetencë tjetër, të dhënë në këtë ligj.

2. Inspektorati i Lartë, në zbatim të përgjegjësive dhe kompetencave të veta, nxjerr akte nënligjore në formën e urdhrave dhe të udhëzimeve.

3. Autoritetet e përcaktuara në shkronjën "b" të pikës 2 të nenit 41 të këtij ligji, mbledhin dhe i dërgojnë Inspektoratit të Lartë, brenda datës 15 prill të çdo viti, deklaratat e plotësuara të interesave, si dhe e njoftojnë atë për rastet e mosdeklarimeve. Këto autoritete mbështesin e kryejnë detyrat e ngarkuara nga Inspektori i Përgjithshëm, për lehtësimin dhe zhvillimin e frytshëm të procesit të deklarimit periodik të interesave. Për punën e kryer, në shërbim të Inspektoratit të Lartë, zyrtarët e këtyre autoriteteve përfitojnë një shtesë 15 për qind mbi pagën mujore.

4. Inspektoratet e ulëta, sipas kuptimit të ligjit të sipërpërmendur, nuk ekzistojnë më me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

## KREU VII
## SANKSIONET

### Neni 43
### **Të përgjithshme**

Trajtimet dhe zgjidhjet e konfliktit të interesave, sipas neneve të kreut IV të këtij ligji, nuk vlerësohen si sanksione, sipas këtij kreu.

### Neni 44
### **Kundërvajtjet administrative**

1. Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas kufijve të përcaktuar më poshtë:

a) për mosvetëdeklarim apo për mosdeklarim me kërkesë, në përputhje me pikat 1 e 2 të nenit 7 të këtij ligji, zyrtari dënohet me gjobë nga 5 000 (pesë mijë) lekë deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

b) për moslëshim autorizimi, sipas pikës 2 të nenit 10 ose të pikës 5 të nenit 14 të këtij ligji, zyrtari dënohet me gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 20 000 (njëzet mijë) lekë;

c) Për mosdeklarim periodik në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, zyrtari ose personi i lidhur me të, që mbart detyrimin për deklarim, dënohet me gjobë nga 20 000 (njëzet mijë) lekë deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;

ç) për shkelje të nenit 21 pikat 1, 2 e 3, nenit 22, nenit 23 pika 1 dhe nenit 24 pika 4 të këtij ligji, zyrtari ose personi i lidhur me të, personi i besuar ose drejtuesi i shoqërisë dënohet me gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

d) për shkelje të pikave 1, 2, 3, 5 e 8 të nenit 38 të këtij ligji, zyrtari ose personi i lidhur me të dënohet me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë;

dh) kur paraqitet gjendja e përcaktuar në shkronjat "a" e "c" të pikës 6 të nenit 40, zyrtari dënohet me gjobë nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 400 000 (katërqind mijë) lekë;

e) në rastet e shkronjave të mësipërme të kësaj pike, gjoba jepet nga Inspektori i

Përgjithshëm, me propozimin e eprorit ose të institucionit epror ose, kur shkelja verifikohet drejtpërdrejt, nga Inspektorati i Lartë;

ë) për shkelje të tjera të këtij ligji, Inspektori i Përgjithshëm, me propozimin e eprorit të strukturës së institucionit, në kuptim të shkronjës "b" të pikës 2 të nenit 41 të këtij ligji, të institucionit epror, ose kur shkelja verifikohet drejtpërdrejt nga Inspektorati i Lartë, dënon personat përgjegjës me gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

f) për çdo masë administrative, Inspektori i Përgjithshëm njofton eprorin ose institucionin epror të zyrtarit të dënuar.

2. Gjobat janë më të larta, sipas vlerësimit të masës së shkeljes dhe sipas nivelit të rritjes së pozitës së zyrtarit.

3. Procedurat për zbatimin e masave administrative dhe ankimin ndaj tyre, rregullohen sipas Kodit të Procedurave Administrative.

4. Gjobat paguhen nga kundërvajtësi dhe derdhen në buxhetin e Inspektoratit të Lartë jo më vonë së 30 ditë nga komunikimi i gjobës. Me kalimin e këtij afati, vendimi i dhënë shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga punëdhënësi, kur kundërvajtësi është në marrëdhënie pune, ose nga zyra e përmbarimit, me kërkesën e Inspektorit të Përgjithshëm.

Neni 45
**Masat disiplinore**

1. Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj nga zyrtarët përbën shkelje disiplinore, pavarësisht nga përgjegjësia penale apo administrative. Masat disiplinore zbatohen në përputhje me ligjet, që rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe/ose statusin e zyrtarëve.

2. Për zyrtarët, që njësohen ose janë anëtarë të organeve kushtetuese, zbatohen masat dhe procedurat e përcaktuara nga Kushtetuta dhe dispozitat ligjore përkatëse.

3. Inspektori i Përgjithshëm, për shkeljen e kryer nga anëtarët e strukturës përgjegjëse të institucionit, në kuptim të shkronjës "b" të pikës 2 të nenit 41 të këtij ligji, i propozon titullarit të këtij institucioni largimin nga funksioni të këtij anëtari.

4. Mosdhënia e autorizimit, sipas pikës 2 të nenit 10 dhe pikës 5 të nenit 14 të këtij ligji, sjell ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin, që rregullon marrëdhëniet e punës.

KREU VIII
DISPOZITA PËR AFATET E ZBATIMIT TË DETYRIMEVE
TË VEÇANTA NË KËTË LIGJ

Neni 46
**Nxjerrja e akteve nënligjore**

1. Në zbatim të këtij ligji, çdo institucion publik, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe të natyrës specifike të funksioneve të tij dhe/ose të çdo zyrtari të tij, miraton akte nënligjore dhe/ose rregullore të brendshme, për hollësi më të qarta e më të plota në lidhje me:

a) kuptimin e vendimmarrjes për një akt dhe kompetencës thelbësore e përcaktuese të një zyrtari, sipas parimeve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 4 të këtij ligji;

b) nënllojet e interesave ose interesat konkretë, që mund të bëhen shkak për lindjen e konfliktit të interesave, si dhe të masës së kufizimit të tyre;

c) kritere dhe tregues për të mundësuar matshmërinë dhe vlerësimin sa më të qartë e objektiv të kryerjes në mënyrë të drejtë dhe/ose të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive nga një zyrtar, për parandalimin e konfliktit të interesave;

ç) procesin e identifikimit dhe të regjistrimit të interesave privatë të zyrtarëve, të lidhur

me konfliktin rast për rast të interesit, sipas kreut II seksioni 1 të këtij ligji;

d) zbatimin e nenit 20, për mbrojtjen e të dhënave;

dh) parandalimin e llojeve të veçanta të konfliktit rast për rast të interesit, të përcaktuara në kreun III seksioni 1 të këtij ligji, për çështjet e mëposhtme:

i) shtrirjen e llojeve të ndalimeve, të përcaktuara në këtë seksion edhe për zyrtarë të niveleve më të ulëta, më të lehta se ato për zyrtarët e përcaktuar në këtë seksion dhe për personat e lidhur me ta (vetëm për kufizimet e përcaktuara në pikat 1 e 2 të nenit 21 dhe për personat e lidhur me ta, në rastet e nenit 21 pikat 1 e 2 dhe nenit 22);

ii) përcaktimin e llojeve të tjera të ndalimeve ose kufizimeve të interesave privatë të zyrtarëve dhe të personave të lidhur me ta, të cilët, megjithëse të papërcaktuar në këtë seksion, vlerësohen të nevojshme për t'u ndaluar ose kufizuar si lloje të veçanta të konfliktit rast për rast të interesit, bazuar në Kodin e Procedurave Administrative, në Kodin Civil ose në Kodin Penal dhe në ligjet që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e institucionit publik përkatës;

e) parandalimin e konfliktit të vazhdueshëm të interesave, sipas përcaktimeve të kreut III seksioni 2 të këtij ligji, për çështjet e mëposhtme:

i) kufizim më pak të lehtë vetëm të interesave të zyrtarëve të përmendur në këtë seksion, krahasuar me kufijtë e interesave të tyre, të përcaktuar në këtë seksion;

ii) rregulla, kritere dhe kufij për shtrirjen e kufizimeve të këtij seksioni te zyrtarët e niveleve më të ulëta dhe personat e lidhur me ta, më të lehta se kufijtë e përcaktuar për zyrtarët e niveleve më të larta;

ë) mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave, të përcaktuara në kreun IV të këtij ligji;

f) detyrat specifike, mënyrën e kryerjes së tyre dhe formën organizative të autoritetit dhe të strukturës përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji, sipas nenit 41;

g) vlerësimin e shkeljeve disiplinore dhe marrjen e masave ndëshkuese, sipas nenit 45 të këtij ligji.

2. Mungesa e akteve nënligjore dhe/ose e rregulloreve të brendshme nuk është justifikim për moszbatimin e këtij ligji. Në mungesë të tyre, ky ligj zbatohet drejtpërdrejt. Ky ligj zbatohet drejtpërdrejt edhe nga institucionet jogjyqësore, kur gjykohet se një akt nënligjor, i nxjerrë në zbatim të tij, bie ndesh me këtë ligj. Bën përjashtim vetëm deklarimi periodik i interesave, që kryhet vetëm në bazë të akteve nënligjore, të nxjerra nga Inspektori i Përgjithshëm.

## KREU IX
## FILLIMI I AFATEVE TË ZBATIMIT TË DETYRIMEVE TË VEÇANTA TË KËTIJ LIGJI

### Neni 47
### Fillimi i afateve të zbatimit të detyrimeve të veçanta të këtij ligji

Efektet e këtij ligji fillojnë menjëherë pas hyrjes së tij në fuqi, me përjashtimet e mëposhtme:

a) detyrimet e përcaktuara në kreun III seksioni 2 të këtij ligji, me përjashtim të detyrimeve, të cilat janë në fuqi për shkak të përcaktimeve në ligje të tjera, të veçanta e për të njëjtin qëllim, fillojnë të zbatohen më 1 tetor 2005;

b) deklarimi periodik i interesave, sipas këtij ligji, fillon të bëhet për herë të parë në vitin 2006 për vitin 2005;

c) jo më vonë së 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, por jo më vonë se data 1 tetor 2005, institucionet publike dhe Inspektorati i Lartë nxjerrin të gjitha aktet nënligjore dhe/ose rregulloret e brendshme, të përcaktuara nga ky ligj.

KREU X
KALIMI NGA DEKLARIMI I PASURIVE TE DEKLARIMI I INTERESAVE

Neni 48
**Kalimi nga deklarimi i pasurive te deklarimi i interesave**

Deklarimi periodik i pasurive dhe i detyrimeve financiare shkrihet dhe zhvillohet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, si deklarim periodik i interesave, bazuar në përcaktimet e krerëve II seksioni 2, VI e VII të këtij ligji, si edhe në parimet, procedurat, afatet, kompetencat dhe dënimet e tjera të përcaktuara në ligjin nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", të cilat nuk janë ndryshuar shprehimisht në këtë ligj të parandalimit të konfliktit të interesave dhe as nuk bien në kundërshtim me të.

Neni 49
**Deklarimi periodik me periudhë deklarimi vitet 2004 e 2005**

1. Deklarimi i pasurive dhe i detyrimeve financiare, që kryhet në vitin 2005, për periudhën e deklarimit nga 1 janari 2004 deri më 31 dhjetor 2004, dhe për deklarimet para fillimit të punës, në çdo rast, që një deklarim i tillë do të kryhet gjatë vitit 2005, si dhe procesi i kontrollit të plotë dhe i hetimit administrativ mbi këto deklarime do të kryhen sipas ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", por duke e ndryshuar dhe përshtatur, për aq sa është e mundur, me përcaktimet e këtij ligji për këto çështje. Inspektori i Përgjithshëm, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, merr të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e kësaj pike.

2. Zyrtarët, që kanë deklaruar të paktën një herë, sipas ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", ose sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të kryejnë deklarim periodik në vazhdim edhe për deklarimin e parë që do të kryhet në vitin 2006, sipas këtij ligji, për interesat e përcaktuar në shkronjat "a" e "b" të pikës 1 të nenit 15 të këtij ligji dhe vlerësohet se kryejnë deklarim para fillimit të punës vetëm për interesat e përcaktuar në shkronjën "b" të pikës 5 të nenit 15 të këtij ligji.

Neni 50
**Shfuqizimet**

Neni 2 pika 4, neni 3 paragrafi i dytë dhe i tretë (së bashku me shkronjat "a", "b" e "c"), nenet 8, 10, 18, 19, 20, 23, 25 pika 1 paragrafi i tretë, i katërt e i pestë, dhe pika 2, si dhe nenet 35, 36, 37, 40 e 41 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", shfuqizohen.

KREU XI
DISPOZITA TË FUNDIT DHE HYRJA NË FUQI

Neni 51
**Indeksimi i kufijve monetarë**

1. Kufijtë e shprehur në monedhë në këtë ligj rriten automatikisht, çdo tre vjet, me të njëjtin koeficient rritës, të barabartë me normën e rritjes së pagës mesatare në administratën publike. Paga mesatare llogaritet si raport i fondit të pagave, përfshirë sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pjesëtuar me numrin e përgjithshëm të punonjësve të të gjitha institucioneve

buxhetore, për të njëjtën periudhë trevjeçare.

2. Fillimi i afatit të llogaritjes është data 1 janar 2006. Këshilli i Ministrave miraton normën mesatare të rritjes së pagave në sektorin publik, brenda muajit korrik të vitit 2009. Më 1 janar 2010, kufijtë monetarë rriten automatikisht sipas kësaj norme.

Neni 52
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4545, datë 29.4.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu**